

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUSI
i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar
“MATI 2023 CONSTRUCTION” sh.p.k
Forma e Shoqërisë**

Neni 1

Sot, më datë 03/07/2023 ne themeluesit, Altin Prifti dhe Marko Prifti, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“MATI 2023 CONSTRUCTION” sh.p.k.** Veprimitaria e saj rregullohet nga ky Statut, Akti i Themelimit dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.
Akti i themelimit dhe Statuti jaë në perputhje me legjislacionin shqiptar dhe çdo çeshtje e paparashikuar shprehimisht në to, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
Themeluesit e shoqërisë janë:

- 1.Z. **SEFER BOCA**, shtetas shqiptarë, i datëlindjes 06.05.1951 i lindur në Macukull, dhe banuese në Rruga. GJERGJ ELEZ ALIA 03920196; Nd.15;H.24; Ap.14; KASHAR; Yzberisht; 1050; Tiranë madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr.037072784 dhe ID F10506102E.
2. Z. **BEHAR FEJZULLA**, shtetas shqiptarë, i datëlindjes 15.05.1981 i lindur në Libofshë, banuese në Rruga. GJERGJ ELEZ ALIA 03920196; Nd.15;H.24; Ap.14; KASHAR; Yzberisht; 1050; Tiranë, madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës e kartës se Identitetit me nr. 036170619 dhe ID G40125313W

Qëndra e Shoqërisë

Neni 2

Selia e Shoqërisë **“MATI 2023 CONSTRUCTION” sh.p.k.** ndodhet ne adresën: FIER Lagja "Kongresi i Permetit", Rruga "Dhimiter Pando", Pallati. Nr.42 Fier. Shoqeria mund te hape filiale te tjera ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe vendin.

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike


Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Neni 4

- Aktivitet ne fushen e Ndertimit, per zbatim: Ndertime shume kateshe civile, industriale, turistike, bujqesore, prodhimin, tregetimin te materialeve te ndertimit, tregetim inertet-gure,



germime dhe punime dheu, sistemime dhe taracime terrenesh, punime muratore dhe beton armeje, ndertime dhe rikonstrusione veprash publike dhe private, ndertime hidrocentralesh dhe objekte te ndryshme civile, industriale, ekonomike, turistike dhe bujqesore, ndertime rrugesh, ndertime urash arti. Gjithashtu shoqeria ka si object veprimtarie shkembimin, blerjen, shitjen, dhenien me qera, menaxhimin dhe administrimin e pasurive te palujtshme te vetat dhe te treteve, lidhjen e kontratave te sipermarrjes si dhe zhvillimin e te gjitha aktivitetave te lidhura direkt dhe indirekt me aktivitetin e ndertimit dhe ate qe ka lidhje me pasurite e palujtshme ne per gjithsi. Kerkime germime: shfrytezime, transport perpunim, eksport-import dhe shitje te materialeve te ndertimit, inerteve, zhavorr bituminoze, rere bituminoze dhe bitum. Import-eksport dhe tregtim meshumice dhe pakice i : Sisteme, pajisjeve dhe materialeve hidraulike, pajisjeve dhe materialeve hidroisanitare, sistemeve, pajisjeve dhe materialeve elektrike, sistemeve te ngrohjes dhe te ftohjes te sistemeve diellore dhe sistemeve te alarmit, sistemeve te vezhgimit, sistemeve te zjarrfikjes, pajisjeve elektroshtepiake, pajisjeve kompjuterike, pjese tendryshme kembim etj. Impoer- Eksport dhe tregtim meshumice dhe pakice i mallrave dhe artikujve te ndryshemushqimore dhe industrial. Investime ne fushen e sherbimeve dhe te turizmit, ngritja dhe administrimi i bareve, restoranteve, hotelereve si dhe aktivitetve te tjera ndihmese te ndervarura apo ne funksion te aktivitetit temesiper, aktivitet ne fushen e transportit te udhetareve dhe te mallrave te ndryshem brenda dhe jashte vendit. Shoqeria mund te bashkpunoje edhe me shoqeri te tjera me objekt te njejtë ose te ndryshem nga i saj. Tregtim fruta perime te fresketa, perime te konservuara, fruta te konservuara, bime medicinale, bime etero vajore.

Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emertimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të riise kapitalin sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve.

Kapitali i shoqërisë

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërise është 100 000 (Një qind mijw) Lekë .

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtmë që nënkuftohet i përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme prej 100.000 lekë. Kjo kuotë i përket ortakëve si më poshtë:

- SEFER BOCA** zotëruar e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50 000 lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- BEHAR FEJZULLA** zotëruar e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50 000 lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të ortakëve.



Drejtimi dhe administrimi

Neni 7

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që permban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 8

Ortakët e shoqerisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit të derdhur prej tij nuk mund ta tërheqin. Kjo mund të bëhet vetem pasi të nxirret bilanci i shoqerisë për fitimin e realizuar.

Neni 9

Emërtimi i shoqerisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratorëve si dhe emrat e ortakëve duhet të jenë të permendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe qe ju drejtohen të tretëve. Shoqeria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

Neni 10

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vete të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtë kontraktore. Ortakët e shoqerisë drejtojnë procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqerisë si dhe për detyrimet qe ka shoqëria ndaj të tretëve pa asnjë kufizim.

Kompetencat e ortakëve

Neni 11

Për mënyrën e drejimit dhe ushtrimit të aktivitetit të shoqerisë, ortaku shprehet me vendime për gjithçka që është në kompetencat e tyre të përshkruara si më poshtë:

Kanë të drejtë të bëjnë ndryshime në statut.

Kanë të drejtë të miratojne bilancin e shoqërise dhe të bëjnë ndarjen e fitimit.

Ata emerojnë administratorët,zëvendësit,ekspertet dhe revizoret kontabël.

Ata aprovojnë çdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marreveshje lihet në kompetencat e tyre

Miratojnë zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit

Përcaktojnë shpërblimin për administratorin, ekspertet, revizoret kontabël.

Bëjnë transferimin e kuotave të të tretët.Bëjnë lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave të shoqerisë si dhe kontrata në lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender ankande ose aktivitete të tjera të rëndësishme.Realizojnë

blerje,shitje si dhe tjetersim të pasurive te paluajtshme të shoqerisë.Kanë të drejtë të bëjnë modifikimin e kontratës së shoqerisë,etj.

Neni 12

Kompetencat e ortakëve, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

Administrimi
Neni 13

Administratori i shoqërisë është caktuar z. **SEFER BOCA**, shtetas shqiptarë, i datëlindjes **06.05.1951** i lindur në **Macukull**, dhe banuese në **Rruga GJERGJ ELEZ ALIA 03920196**; Nd.**15; H.24; Ap.14; KASHAR; Yzberisht; 1050; Tiranë madhore** me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr.037072784 dhe ID F10506102E .

Afati i mandatit eshte 5 (pesë) vjet.

Neni 14

Administratori mund të emeroje një ose më shumë administrator të deleguar ose perfaqesues te thjeshte per te kryer veprime te vecanta duke percaktuar fuqine e tyre brenda kufijve e duke respektuar statutin dhe ligjet ne fuqi. Detyrat e tyre do te percaktohen ne një regullore te brendshme te shoqerise.

Neni 15

Administratori ka liri të plotë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryeje të gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marrëveshje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe Statut që i takojnë ortakëve. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore hartohen nga Administratori.

Marrëdhëniet e punës
Neni 16

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe te punësuarit janë te detyruar qe të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendëshme të saj. Të punësuarit duhet te pergjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Konfidencialiteti, ruajtja e sekretit
Neni 17

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratori i shoqërisë.

Ekspertet ose revizoret kontabeë
Neni 18

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do te qendroje ne detyre për aq sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Ortakët caktojnë dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore. Asambleja e Ortakeve. Sherbime konsulence ne Bujqësi dhe ne funksion te objektit dhe aktivitetit qe parashikon legjislacioni ne fuqi.

Viti finanziar, bilanci vjetor, shpërndarja e fitimeve
Neni 19
Viti finanziar

Viti finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit. Viti i parë finanziar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe përfundon me 31 dhjetor të të njëjtit vit.
Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin finanziar duhet të bëhen brenda 6 muajve që nga fundi i vitit finanziar.

Bilanci dhe fitimet
Neni 20

Veprimtaria ekonomike do te mbyllte ne 31 dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit ,rezultatit ekonomik fitim-humbje dhe inventarit. Pasi vecohen fondet si me siper paguhën detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten i kalojne ortakeve te shoqerise.

Neni 21
Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortakët vendosin brenda 4 muajve mundësinë e prishjes së jashtëzakonshme të shoqërisë.

Shpërndarja dhe likuidimi i shoqërisë
Neni 22

Në rast se shoqëria shpérndahet për cdo lloj arsyen asambleja e ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentat e nevojshme për çregjistrimin e saj nga regjistri tregtar.

Librat e shoqërisë
Neni 23

Po kështu shoqëria në bazë të ligjit mban librat e mëposhtëm:

1-libri i ortakeve

2-libri i mbledhjeve

3-libri i vendimeve të administratorit

4-libri i mbledhjeve dhe vendimeve të ekspertëve ose revizoreve kontabël

Librat e mësiperm duhet të jenë të ruajtura për 10 vjet e çdo faqe duhet të jetë e vulosur.

Dispozita te pergjitheshme

Neni 24

Për sa është shprehur në këtë statut i referohemi Ligjit 9922, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", Statutit dhe regullores së brendshme të shoqëris. Çdo ndryshim bëhet në të njëjtën mënyrë sic është nxjerrë ky statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

**Ortakët e
Shoqërisë me Përgjegjesi të Kufizuar**

"MATI 2023 CONSTRUCTION sh.p.k.

SEFER BOCA



Fier më 03/07/2023

BEHAR FEJZULLA

